



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:030072

Datë: 15.11.2021

Numri i dokumentit: 02394807

III.EK.nr.100/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia - Ymeri, në çështjen juridike të paditëses [“S...”]Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [“A.N”], kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti rimbursim i borxhit, në seancën dëgjimore për ndërmjetësim me datën 12.11.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se paditësja [“S...”]Sh.A., me seli në Prishtinë, në këtë çështje juridike, e ka tërheqë padinë kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti rimbursim i borxhit.

A r s y e t i m

Paditësja më datën 16.02.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, për rimbursim borxhi, duke kërkuar nga gjykata që pas administrimit të gjitha provave relevante të njëjtën ta aprovojë si të bazuar.

Pala paditëse në seancën dëgjimore për ndërmjetësim me datë 12.11.2021, e ka njoftuar gjykatën se pala paditëse e tërheq padinë kundër të paditurës meqenëse në rastin konkret është paguar dëmi, andaj ka kërkuar nga gjykata që konform dispozitave të LPK-së padia e paditësit të konstatohet e tërhequr.

Andaj, në bazë të nenit 261 par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilin parashihet se *” Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”* dhe nenin 261 par.3 në të cilin parashihet se *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Duke pasur parasysh rrethanat e lartë cekura, konsiderohet se paditësi në këtë çështje juridike e ka tërheqë padinë konform nenit 261 par.2, par.3 dhe par.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.EK.nr.100/21 me datën 12.11.2021

Gjyqtarja
Franciska Zhitia - Ymeri

KËSHILLË JURIDIK: Bazuar në nenin 261.4 të LPK-së, ndaj këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.